REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 66/17
Datë/Datum. 30.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit Komuna Gjilan	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **66/17** e OE **"Vision Project"** - Gjilan.		
Datë:	30.03.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 06.03.2017 me Nr. **66/17** nga OE **"Vision Project"** - Gjilan, për shqyrtimin e lëndës **"Ndërtimi i palestrës sportive në fshatin Zhegër" me numër të prokurimit GI651/16/045/511** , të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Gjilan (KGJ).**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA GJILAN.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **VISION PROJECT.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		20.03.2017		**20.03.2017**		**30.03.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 06.03.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 66/17 e parashtruar nga OE **"Vision Project"**, me seli në Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i palestrës sportive në fshatin Zhegër" me numër të prokurimit GI651/16/045/511** , të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Gjilan (KGJ).**
Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komunës së Gjilanit (KGJ).**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "Vision Project", me seli në Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE **"Vision Project"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 10 – Mjetet për promovimin e Transparencës;
Neni 52 – Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës;
Neni 56 - Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave;
Neni 57 – Sigurimi i Tenderit;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 60 – Kriteret për dhënie të kontratës.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Fillimisht ju njoftojmë se ne kemi qenë ankues në herën e parë dhe na është aprovuar ankesa nga ana juaj si e bazuar dhe lënda është kthyer në rivlerësim duke u shpallur të dy operatorët ekonomik të renditur para neve të papërgjegjshëm. Pas rivlerësimit të ofertave AK përsëri e ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm sikurse herën e parë dhe njëkohësisht e ka shpallur të përgjegjshëm edhe operatorin e dytë me çmim më të lirë, e që edhe ky është shpallur i papërgjegjshëm me vendimin tuaj nr.414-16 të dt: 16.01.2017. Ndërsa neve edhe këtë herë na shpall si tenderues të pasuksesshëm.

Ne përsëri kemi kërkuar qasje në dokumentacion të OE fitues dhe të OE të renditur i dyti me çmim, sikurse herën e parë, ndërsa tani na është kufizuar qasja në dokumente në kundërshtim me dispozitat e nenit 10 të LPP, pasi që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka deklaruar sekret afarist asgjë. Mirëpo ne i kemi dëshmitë dhe faktet edhe nga qasja në herën e parë e të cilat po i parashtrojmë edhe njëherë.

Në qasjen tonë në dosjet e tenderëve kemi vërejt se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kriteret e kërkuara sipas FTD dhe njoftimit për kontratë.

Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale, stafi i ofruar nga OE nuk i ka të përmbushur këto pika sipas kërkesës në FTD pasi që:

1. Ing i ndërtimtarisë drejtimi hidro z.Nexhat Merovci, nuk e ka të dëshmuar me referenca dhe me asnjë dëshmi tjetër përvojën e punës prej 5 vite, ku ka të lëshuara dy referenca nga OE Ariani (autoreferenca) mirëpo nuk i ka te cekun vitet në të cilat ka punuar, çka do të thotë se nuk e ka plotësuar kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë që të ketë përvojë 5 vjeçare dhe në mungesë

të këtyre dëshmive është papërgjegjshëm operatori ekonomik rekomanduar për kontratë.

2. Ing i elektroteknikes Bajram Beqiraj e ka një autoreferencë ne OE Ariani, nuk e dëshmon se ka përvojën e duhur dhe nuk e ka dëshmuar me referenca ose dëshmi tjera që ing në fjale e plotëson kërkesën e OE.

3. Ing i makinerisë z.Ferat Berisha nuk posedon asnjë reference dhe asnjë dëshmi që e dëshmon përvojën e punës dhe në mungesë të këtyre dëshmive nuk plotësohet kërkesa e FDT-së dhe e njoftimit për kontratë që inxhinieri i makinerisë duhet të ketë pesë vite përvojë pune, prandaj ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm në mungesë të dëshmive të tilla.

4. Ing Kushtrim Krasniqi e ka vetëm një reference dhe ajo nuk e dëshmon periudhën kohore, ndërsa në CV e tij shkruan se punon prej vitit 2006 e deri në vitin 2014, kurse në diplomën e tij shkruan se ka diplomuar me 20.12.2011 që do të thotë se me 20.12.2016 i ka bërë 5 vite përvojë pune si inxhinier i diplomuar, kurse dorëzimi dhe hapja e ofertave është bërë me dt. 12.07.2016 çka na jep të kuptojmë se kërkesa e autoritetit kontraktues që inxhinieri i gjeodezisë të ketë pesë vite përvojë pune profesionale nuk është përmbushur nga ana e operatorit të rekomanduar për kontratë, prandaj ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPPsë ku thuhet "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Ndërsa me këto dëshmi të dorëzuara nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë rezulton se nuk janë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktues. Lidhur me këtë pikë dhe pikat tjera të papërmbushura nga ky operator në lidhje me dëshmitë e inxhinierëve nuk mund të kërkohen sqarime shtesë dhe nuk mund të ketë plotësime të dokumenteve pasi që edhe neni 72 paragrafi 3 i LPP-së, parasheh që "Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive". Prandaj në këtë rast është e qartë se në momentin e ofertimit kjo kërkesë nuk është plotësuar dhe se nuk mund të bëhet ndonjë ndryshim eventual pasi që diploma e inxhinierit në fjalë është e qartë kur ka diplomuar. Gjatë qasjes në dokumente më është thënë se nuk e kemi parë këtë fakt.

OE Ariani Co si OE i rekomanduar për kontratë, nuk e plotëson edhe kërkesën e FDT-së pasi që është kërkuar lista e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit 2013, 2014, 2015 OE duhet të ketë tre referenca/kontrata për ndërtimin e lartë, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka vetëm një kontrate për këto tri vite dhe atë e ka me MFSK në vlerë prej 795,327.40e *2013-2014. Kurse dy kontrata tjera, njërën me MASHT dhe njërën me MKRS, nuk mund të hynë ne procesin e vlerësimit pasi këto janë të nënshkruara si në vijim, kontrata me Masht - 15.12.2009 dhe me MKRS- 18.11.2009 që i bie se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar referenca për kontratat e realizuara gjatë gjashtë viteve të fundit. Këtu është trajtimi jo i barabartë i operatorëve ekonomik ofertues konform nenit 7 të LPP-së, ngase këtij operatori ekomomik i vlerësohen kontratat e realizuara gjatë gjashtë viteve të fundit ndërsa operatorëve tjerë gjatë tri viteve të fundit ashtu siç është kërkuar. Njëkohësisht është shkelur edhe neni 52 dhe 56 i LPP. Siç dihet këto kërkesa kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike financiare e ku në nenin 68 parashihet që, citojmë "Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do ti referohen maksimum tri viteve të fundit financiare" mbarim citati. Pra kjo kërkesë mund të jetë maksimumi për tri vitet e fundit e jo për gjashtë vitet e fundit, pasi që në këto raste kërkohet që të dëshmohet dhe vërtetohet se operatori ekonomik a ka kapacitet ekonomik dhe financiar për të realizuar kontratat

përkatëse.

Te lista e makinerisë OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e sipas FTD.

Te lista e makinerisë OE nuk e plotëson kërkesën e sipas FTD. Kërkesa specifike e AK-së ka qenë te kërkesa nr 3. Kamion 10-12m3, kurse OE ka ofruar 1 Kamion Mercedes actros 4143, 14.475 kg/ 14m3, dhe 2. Kamion Actros 4.143 15420kg/ 15m3, këtë mospërputhje e ka vërtetuar edhe eksperti shqyrtues dhe vetë vendimi i panelit shqyrtues të OSHP-së me nr.414-16 e ku është sqaruar dhe deklaruar i papërgjegjshëm operatori ekonomik Ariani Co, mirëpo që ky vendim i OSHP-së nuk është respektuar nga ana e AK as gjatë rivlerësimit të ofertave, ndërsa dihet që vendimet e OSHP-së janë të formës përfundimtare dhe të ekzekutueshme. Me ligjin e prokurimit publik dihet qartë që kur caktohen minimumi dhe maksimumi i ndonjë parametri atëherë duhet të ofertohet brenda këtyre kërkesave ose parametrave, përndryshe operatori ekonomik i cili nuk oferton në këtë mënyrë dhe brenda këtyre parametrave atëherë shpallet i papërgjegjshëm. Vinçi nuk përputhet me dudin doganore, poashtu edhe eskavatori 3.5ton nuk e plotëson kërkesën Vlen të ceket se OE ka tre fatura nga OE Vraniqi Comerce shifet se është i njëjti shkrim dhe njëjta forme e faturave edhe është interesante se për vite te ndryshme janë faturat me nr rendor te njëjtë

fat 03/11 dit: 15.03.201 ||

fat 04/07 dit: 23.04.2007

fat 05/11 dit: 09.06.201 1

Përfundimisht autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë një operator ekonomik të papërgjegjshëm dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe vendimi i OSHP Nr. 41416 të dit: 16.01.2017

Gjithashtu edhe operatorin ekonomik të renditur i dyti me çmim e kanë shpallur të përgjegjshëm OE "H-Projekt&Pleqja", i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktues, madje edhe për këtë operator ekonomik vendimi i panelit shqyrtues e ka konfirmuar që ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm për shumë pika. Pjesa C, formulari është i vulosur nga dy kompanitë mirëpo H-project i pa nënshkruar, Krijimi i një grupi të OE janë kërkesat e qarta në FTD, OE në konzorcium nuk i ka të përmbushura kërkesat sipas FTD, pika a,b,c,d (OE Pleqja e ka të shënuar që do të ofroj mbështetje studimore dhe profesionale OE H-Project) Nuk i ka përmbushur kërkesat sipas nenit 71 të LPP-së - Menaxheri i projektit: Caktimi i vendimit e ka bërë OE Pleqja anëtari i konzorciumit mirëpo ky vendim është i pa nënshkruar dhe pa vulosor dhe i njëjti vendim nuk është për këtë projekt mirëpo është vendimi i një projekti tjetër. Ndërtimi i qendrës se Mjekësisë familjare ne Gjilan

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar Qarkullimi bankar në tri vitet e fundit në vlerë 1,500.000.00 € Dëshmia e kërkuar dokumentare: Qarkullimi bankar në tri vitet e fundit 1,500.000.00€ të dëshmohet me qarkullim bankar ose me raporte të auditorëve të pavarur dhe të licencuar. OE H Projekt ka ofruar qarkullim bankare nga 11.07.2013-11.07.2016 - 814,844.056, OE Pleqja nuk ka ofruar dëshmi bankare, prandaj ky konzorcium është i papërgjegjshëm, këtë e ka konfirmuar dhe vërtetuar edhe vendimi i OSHP nr.41416 idt:16.01.2017.

III.2.4).Kapaciteti teknik dhe profesional

Referencat për punët e kryera në lëmin e ndërtimit të lartë në tri vitet e fundit 2013,2014.2015 minimum (3) referenca.

Menaxherin e projektit Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv (5 vite ose master) Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi Hidros (5 vite ose master) Një inxhinier i diplomuar i Arkitekturës drejtimi konstruktiv (5 vite ose master) Një inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës (5 vite ose master) Një inxhinier i diplomuar i Makinerisë (5 vite ose master) Një lng. Gjeodezis(bachelor)

Mekanizimi i nevojshëm

OE H Project ka ofruar:

1. Ing Xhafer Xhelili (kontratë e përkohshme) në CV e ofruar në dosjen e tenderit

nuk e ka të shënuar përvojën e punës, nuk ka as referenca, prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

2. Ing i makinerisë Muharrem Ramadani (kontrate e përkohshme) ne CV e ofruar ne dosjen e tenderit nuk e ka të shënuar përvojën e punës, nuk ka as referenca prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

3. Ing hidroteknik Feriz Tërstena (kontrate e përkohshme) në CV e ofruar në dosjen e tenderit nuk e ka te shënuar përvojën e punës, nuk ka as referenca prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

4. Ing i elektroteknikes Xhevat Rramani (kontratë e përkohshme) në CV e ofruar në dosjen e tenderit nuk e ka te shënuar përvojën e punës, nuk ka as referenca prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

5. Ing arkitekturës Bashkim Hoxha (kontratë e përkohshme) ne CV e ofruar ne dosjen e tenderit nuk e ka te shënuar përvojën e punës, nuk ka as referenca prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

6. Ing gjeodezisë Nevzat Pira, (kontratë e përkohshme) në CV e ofruar ne dosjen e tenderit nuk e ka të shënuar përvojën e punës, nuk ka as referenca prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

7. Ing ndërtimtarisë Muhedin Morina (kontratë e përkohshme), diploma e noterizuar kopje me ngjyra jo origjinal nga noteri nuk ka CV, nuk ka as referenca prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

8. Ing ndërtimtarisë Sami Idrizi, nuk ka kontratë, diploma e noterizuar kopje me ngjyra, nuk ka as CV as referenca prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

9. Ing makinerisë Lulzim Kryeziu, nuk ka kontratë, diploma e noterizuar kopje me ngjyra, nuk ka as CV as referenca prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

- Agron Halitika të ofruar vetëm një kontrate, nuk ka diplomë nuk ka CV prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

- Arafat Basha ka vetëm CV (nuk ka kontratë nuk ka diplomë nuk ka CV) prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

- Valon Hyseni-bach arkitektur dipl e pa noterizuar, s'ka kontratë s'ka CV prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

OE në konzorcium Pleqja edhe ky OE nuk i plotëson kërkesat për ing e kërkuar ne FTD: 1. ing Arkitekturës Ardita Berisha, e ka te ofruar diplomën e pa noterizuar, nuk ka referenca dhe dëshmi për përvojën e punës prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

2. Ing ndërtimtarisë Afrim Brovina, e ka te ofruar diplomën e pa noterizuar, nuk ka referenca, nuk ka referenca dhe dëshmi për përvojën e punës prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

3.Ing gjeodezise Lutfi Krijeva e ka te ofruar diplomën e pa noterizuar, nuk ka referenca nuk ka referenca dhe dëshmi për përvojën e punës prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

4. Ing makineri Skender Mushkolaj e ka të ofruar diplomën e pa noterizuar, nuk ka referenca nuk ka

referenca dhe dëshmi për përvojën e punës prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

5. Ing elektroteknik Agron Lleshi e ka te ofruar diplomën e pa noterizuar, nuk ka referenca, CV e ka copy përvojën e punës nga ing Skender Mushkolaj ku e ka përshkrimin ne CV se ka përvojë ne ndërtimin te ulet prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

Lista e kontratave H- Project

Lista e ofruar nga OE H Project, nuk përkon me kontrata që janë ne dosjen e tenderit, nuk ka kontrata të ndërtimit të lartë, janë disa kontrata private mirëpo për te cilat s'ka te ofruar qarkullimin bankar, ne listën e kontratave figurën projekti : Ndërtimi i ambulantes në Kllokot mirëpo nuk ka kontratë as pranim teknik apo referencë, poashtu Ndërtimi i çerdhes në lagjen Dardani s'ka kontratë as pranim teknik apo referencë, s'ka tre referenca të ndërtimit të lartë prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

Lista e kontratave OE Pleqja Në listën e kontratave të ofruar nga OE Pleqja ka kontrata të pa përfunduara dhe të gjitha këto kontrata kanë vlerën 1269.892.97e, ndërsa kërkesë në FTD ka qenë vlera e qarkullimit në ndërtimin e lartë duhet të jetë 1,500,000.006, qarkullim bankar nuk ka të ofruar Ky OE nuk i ka tri kontrata së bashku me pranim teknik apo referenca të ndërtimit të lartë, prandaj në mungesë të këtyre dëshmive është i papërgjegjshëm.

OE në konzorcium nuk i plotëson as kërkesat për mekanizmin e kërkuar në FTD. Vinq/ kran nuk posedojnë në listën e mekanizmit, nuk posedojnë dëshmi për shtylla e skele siç është kërkuar dudi doganor apo kontratat e shitblerjes, kjo është vërtetuar dhe konfirmuar edhe me vendimin e OSHP-së. SQARIM:Ju njoftojmë se lidhur me dëshmitë e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe të operatorit ekonomik të dytë të shpallur të përgjegjshëm nga ana e autoritetit kontraktues, ne kemi pasur qasje në dokumente të këtyre dy operatorëve ekonomik edhe në herën e parë ku i kemi konfirmuar këto parregullsi. Me këtë rivlerësim nuk është respektuar neni 60 i LPP-së-kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, ndërsa në këtë rast përsëri edhe në kundërshtim me këtë nen dhe në kundërshtim edhe me vendimin e OSHPsë është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm në kundërshtim me nenin 59 të LPP. Pra pa u përmbushur kriteri kryesor tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Kërkojmë nga OSHP që të shqyrtohet edhe njëherë vendimi i KK Gjilan që ka rekomanduar për kontratë përsëri operatorin ekonomik të papërgjegjshëm, e i cili është shpallur edhe me vendimin e juaj të OSHP-së nr.414-16 të dit: 16.01.2017 dhe ti analizoni edhe njëherë këto fakte që i cekëm, dhe ta detyroni KK Gjilan që të anulojë vendimin për dhënie të kontratës dhe të kthehet lënda në rivlerësim dhe të merren parasysh kërkesat FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, pasi që të dy operatorët e renditur me çmim më të ulët se ne janë të papërgjegjshëm dhe ne jemi fitues potencial të kësaj kontrate.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 01.06.2016

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Punë/vlerë e madhe

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 12.07.2016

Data e hapjes së ofertave .....12.07.2016-14:30^{h}

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1)Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Deklarata nën betim, Zotimin e OE se i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit 04/L-042, Neni 65
2. Dëshminë se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit.
3. Dëshminë nga gjykata ekonomike se OE se i përmbush kriteret sipas nenit 65 të LPP

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit 04/L-042, Neni 65 e nënshkruar dhe vulosur për secilin partner të një grupi operatorësh ekonomik(**formularin që është pjesë dosjes së tenderit**).
2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit - ***për operatorin ekonomik i cili shpërblehet me kontrat origjinal***

Dëshminë nga gjykata ekonomike se OE se i përmbush kriteret sipas nenit 65 të LPP- ***për operatorin ekonomik i cili shpërblehet me kontrat origjinal***

III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:

1. Certifikata e biznesit veprimtaria përkatëse
2. TVSH

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1 Certifikata e biznesit veprimtaria përkatëse-***kopje.***

3. *TVSH* ***kopje.***

III.2.3)Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Qarkullimi bankar në tri vitet e fundit në vler 1,500,000.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Qarkullimi bankar në tri vitet e fundit 1,500,000.00 € të dëshmohet me qarkullim bankar ose me raporte të auditorëve të pavarur dhe të licencuar.

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Referencat për punët e kryera në **lëmin e ndërtimit të lartë** në tri vitet e fundit 2013,2014,2015 minimum (3)referenca.
2. Menaxherin e projektit
3. Një inxhinier i diplomuar i ndërtimitarisë drejtimi konstruktiv (5 vite ose master)
4. Një inxhinier i diplomuar i ndërtimitarisë drejtimi Hidros (5 vite ose master)
5. Një inxhinier i diplomuar i Atkitektures drejtimi konstruktiv (5 vite ose master)
6. Një inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës (5 vite ose master)
7. Një inxhinier i diplomuar i Makinerisë (5 vite ose master)
8. Një Ing. Gjeodezis(bachelor)
9. Mekanizimi i nevojshëm

Lloji i makinës ***nr minimal***

1	Eskavator, kapac. 12-22 T	2
2	Eskavator, kapac. 3 –5 t	1
3	Kamion 10-12 m3	2
4	Cilindër	1
5	Grejder	1
6	Vinç (kran) static L=40m 1.5 t	1
7	Skele ,shtylla	2400 m^2

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Lista e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit 2013,2014,2015 të dëshmohet me referenca ose raporte të pranimit të teknik të punëve ku qart të ceket emri i projektit, vendi i realizimit koha e realizimit dhe vlera e projektit**lista duhet të jet origjinale e nënshkruar dhe vulosur**
2. Menaxherin e projektit duhet të jet ing. Dip. Arkitekturës ose ndërtimtaris me një përvoj pune prej 5 viteve të caktohet me shkres **dhe të jet i vulosur nënshkruar-Origjinal**
3. Ingjinierat prej pikës 3 deri 8 duhet të ken diplomë, CV-in dhe një përvoj pune 5 vite, **diplomat e ingjinierave duhet të jenë të noterizuara**
4. Lista e mekanizimit (Mjetet motorike që regjistrohen të ken librezë valide të regjistrimit kurse mjetet tjera të dëshmohen me dud doganor, kontrata të shitblerjes, **kurse marrveshtje mbi huazimin e mjeteve duhet të jet e noterizuar) gjithashtu lista e mekanizimit duhet të jetë origjinale e nënshkruar dhe vulosur.**

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Isars Construction"	Prishtinë	1,378,785.02€	JO
2.	"Mercom Company"	Prishtinë	1,274,426.26€	JO
3.	"Engineering"	Viti	1,254,853.43€	JO
4.	"Al-Trade"	Prishtinë	1,275,989.70€	JO
5.	**"Vision Project"**	**Gjilan**	**1,108,857.74€**	JO
6.	"Mega"	Gjilan	1,499,999.60€	JO
7.	"Arch Ndërtimi"	Gjilan	1,281,694.37€	JO
8.	"Olti Trasing"	Prishtinë	1,183,584.32€	JO
9.	"Ceh Group"	Gjilan	1,399,570.00€	JO
10.	"H-Project"	Gjilan	984,895.46€	JO
11.	"Beni Construction"	Viti	1,254,761.66€	JO
12.	"Dea Group"	Gjilan	1,421,399.09€	JO
13.	"Loda Desing"	Prishtinë	1,155,551.54€	JO
14.	**"Arian-Co"**	**Prishtinë**	**978,774.59€**	JO
15.	"G&A Construction"	Prishtinë	1,255,555.55€	JO
16.	"Pro&Co Group"	Kllokot	1,184,107.58€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Izet Kurteshi - Kryetar i komisionit
- Isuf Berisha - Anëtar i komisionit
- Ramadan Gashi - Anëtar i komisionit

Data e mbarimit të vlerësimit: 08.02.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....08.02.2017

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....14.02.2017

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:

Nr.	Emri i tenderuesit të Përgjegjshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
1.	**Arian-Co**	**978,774.59€**	**1**
2.	H-Project	984,895.46€	**2**
3.	**Vision Project**	**1,108,857.74€**	**3**
4.	Loda Desing	1,155,551.54€	
5.	Pro&Co Group	1,184,107.58€	
6.	Mercom Company	1,277,426.26€	
7.	Beni Construction	1,254,761.66€	
8.	Al-Trade	1,275,989.70€	

Raporti i komisionit vlerësues:
Kompania e cila ka ofertuar me ofertën e përgjegjshme dhe me çmim me lire është "Arian Co" – Prishin, me çmim prej: 978,774.59, prandaj komisioni rekomandon për ta shpallur fitues te kontratës .

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik në lidhje me arsyet e eliminimit.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE ankues konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, ja refuzon ankesën si të pa bazuar.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi lidhur me përvojën e inxhinierit te makinerisë. Sipas OE ankues OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me ketë kërkese.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne dosje te tenderit është kërkuar, Një inxhinier i diplomuar i Makinerisë duhet të ketë diplomë, CV-in dhe një përvojë pune 5 vite, diplomat e inxhinierëve duhet të jenë të noterizuara. Eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ne ofertën e tij ka ofruar diplomën, kontratën e punës, CV-in ne te cilën edhe janë dhenë përshkrimet e punëve te kryera apo te menaxhuara nga Inxhinieri i Makinerisë - hidro, qe sipas CV-se, përvoja e këtij Inxhinieri është qe nga viti 2004-2016.

Sa i përket pretendimit, lidhur me Inxhinierit te Elektroteknikes, është i paqëndrueshëm për faktin se i ka dorëzuar Diplomën, kontratën dhe CV-in ne te cilën ka dëshmuar përvojën.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues se inxh. i makinerisë nuk ka ofruar dëshmi ne lidhje me përvojën, eksperti shqyrtues, sqaron se inxhinieri ne fjalë nuk ka ofruar referenca por ka ofruar CV ku i ka përshkruar disa projekte te menaxhuara.

Eksperti shqyrtues, ne vazhdim sqaron se OE ankues pretendon se, inxhinieri i Gjeodezisë i prezantuar ne ofertë te OE te rekomanduar për kontratë, nuk e ka përvojën e kërkuar dhe se përvoja e përshkruar ne CV-in e inxh. te lartpërmendur nuk perputhet me diplomimin e inxh. te Gjeodezis i cili sipas OE ankues ka diplomuar me date 20.12.2011. Eksperti shqyrtues lidhur me kete pretendim sqaron se diploma e inxh te lartpërmendur mban daten: 20.12.2011 dhe se ky inxhinier sipas dëshmive ne ofertë është licencuar si Gjeodet pran Agjencisë Kadastrale te Kosovës me datën: 12.03.2015.

Eksperti shqyrtues, ne lidhje me këtë pretendim sqaron se përvoja e paradiplomimit e paraqitur ne CV-in e këtij inxhinieri, nuk mund te merret parasysh si përvojë e inxh. te gjeodezisë. Andaj, duke u bazuar ne sqarimin e mësipërm lidhur me diplomën e inxh. te gjeodezisë dhe ne kërkesën e dosjes se tenderit ku AK-ja, ka kërkuar qe inxh. i gjeodezisë te ketë pervoj pune 5 vite, eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar këtë kërkesë te dosjes se tenderit, për faktin se nga data e diplomimit dhe deri ne dorëzimin e ofertave me 12.07.2016, nuk e përmbush kërkesën për pesë vite përvojë pune.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën për tri kontrata dhe referenca ne ndërtim te lart, eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ne ofertë sipas kerkeses e ka dorëzuar vetem nje kontratë me titull: Ndërtimi i banjove kolektive ne kazermat e FSK-se faza e pare 2013 dhe faza e dyte 2014 bashkangjitur dhe referencën, ndersa dy kontrata tjera te cekura edhe ne ekspertizen e kaluar jane te nënshkruara ne vitin 2009 - Ndërtimi i shkollës se mesme ne Viti dhe Ndërtimi i palestres sportive ne Decan. Ndersa per kontraten Ndërtimi i palestres sportive ne Kaçanik nuk ka procesverbal te pranimit teknik apo referenc dhe ne fund te ofertes se tij e ka dorezuar edhe nje kontrate e cila nuk ka pranimi perfundimtare te punimeve.

Nga sqarimi i mësipërm eksperti shqyrtues sqaron se përkundër kërkesës se bere ne raportin e pare te ekspertizës për verifikim te këtyre kontratave, eksperti shqyrtues sqaron se vetëm një kontratë është sipas kërkesës se dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Sa i përket pretendimit te OE ankues ne lidhje me pajisjet e kërkuara për projektin ne fjalë, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se ne dosje te tenderit është kërkuar kamion 10-12m^3, ndërsa ne ofertë OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi për kamion mbi 14m^3. Prandaj fakti qe AK-ja, ne dosje e ka përcaktuar minimumin dhe maksimumin e

peshës se kësaj makinerie, eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka ofruar dokumentet sipas kërkesës se dosjes se tenderit, pra është dashur qe pajisja te jet brenda parametrave te lejuara ne kërkesën e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues se vinçi i OE te rekomanduar për kontratë, nuk përputhet me dudin doganor, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se kërkesa ne dosje te tenderit ka qene qe OE-te te ofrojn si dëshmi edhe kontratat e shitblerjes se makinerisë dhe ne rastin konkret OE i rekomanduar për kontratë e ka ofruar kontratën e shitblerjes dhe faturën tatimore te vinçit.

Sqarimi nr.3

Sa i përket pretendimeve te OE ankues, lidhur me ofertën e dyte "H-Project", eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues pretendon se OE "H-project" është i papërgjegjshëm me arsyetimin se nuk e ka nënshkruar formularin e tenderit anëtari i konzorciumit "Pleqja". Eksperti shqyrtues sqaron se me vendim lider i konzorciumit është OE "H-project", ne te cilën nder te tjera thuhet se: H-Project do te hartoj pjesën financiare, gjithashtu eksperti shqyrtues, sqaron se formulari i tenderit është i vulosur nga anëtari i konzorciumit, prandaj, ky pretendim i OE ankues është i paqëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, lidhur me themelimin e konzorciumit dhe detyrave dhe përgjegjësive te përcaktuara ne ligj, eksperti shqyrtues, sqaron se OE Konz. "H-Project&Pleqja", ka ofruar deklaratat e tyre lidhur me themelimin e konzorciumit dhe përgjegjësive te anëtareve te konzorciumit veq e veq, mirëpo eksperti shqyrtues sqaron se ne ofertë mungon deklarata permes te ciles eshte dashur te deklarojn se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit, prandaj, kjo kërkesë nuk është plotësuar sipas nenit 71 te LPP-se. andaj, ky pretendim i OE ankues eshte i qendrueshem.

Lidhur me pretendimin se caktimi i menaxherit te projektit e ka bere anetari i konzorciumit, eksperti shqyrtues, sqaron se ne ofert te OE "H-Project", gjendet vendimi per te cilin pretendon OE ankues, mirëpo ne ofert gjendet edhe vendimi i Liderit te konzorciumit i cili e ka caktuar menaxherin e projektit, per te cilin edhe ka ofruar CV-in, kontratën dhe diplomën e noterizuar.

Lidhur me pretendimin tjeter se OE "H-project", nuk ka ofruar dëshmi lidhur me kërkesën 8.1 te FDT-se, ku është kërkuar qe OE te dëshmoj qarkullim 1,500.000.00 euro, eksperti shqyrtues, sqaron se operatori ekonomik i lartpërmendur nuk e ka plotësuar kërkesën 8.1 te FDT-se, ne ofertë ka dorëzuar qarkullimin bankar prej: 814,844.05 euro. Prandaj, ky pretendim është i qëndrueshëm.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues se stafi profesional i kërkuar ne piken 9.1 te FDT-se, kane kontrata te përkohshme, eksperti shqyrtues sqaron se OE "H-Project", ka kontata te përkohshme për kryerjen e shërbimeve, te cilat janë valide dhe ne përputhje me kërkesën e dosjes se tenderit. Ndërsa sa i përket inxhinierit te makinerisë, inxhinierit Agron Haliti, Arafat Basha dhe inxhinierit Valon Hyseni, eksperti shqyrtues, sqaron se me te drejte pretendon se këta inxhinier nuk e kanë plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit, mirëpo eksperti shqyrtues gjate ekzaminimit te ofertës se konz. OE "H-Project&Pleqja", ka vërejtur se anëtari i konzorciumit "Pleqja", i ka plotësuar me staf inxhinieret për te cilët pretendon ankuesi se nuk i ka plotësuar OE "H-Project". Prandaj, eksperti shqyrtues, sqaron se konform nenit 71.3 te LPP-se, Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues se edhe OE "H-Project", nuk e përmbush kërkesën për kontrata dhe referenca, eksperti shqyrtues, sqaron se OE "H-Project", i ka ofruar disa kontrata me OE privat dhe kryesisht me persona privat, ndërsa anëtari i konzorciumit i ka ofruar disa kontrata te cilat nuk korespondojn me vitet e kërkuara nga AK-ja, ne dosje te tenderit dhe disa tjera i ka pa pranim teknik. Andaj, ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm.

Gjithashtu ne lidhje me pretendimin e OE ankues se OE "H-Project&Pleqja", nuk i kane ne posedim skelet/shtyllat – 2400m^2, eksperti shqyrtues sqaron se konzorciumi ne fjale nuk ka ofruar dëshmi për pajisjet ne fjalë, dhe poashtu edhe ne listën e pajisjeve nuk e ka prezantuar si pajisje OE "Pleqja", ndërsa lideri i konzorciumit vetëm e ka përshkruar ne liste si pajisje Skelet/shtyllat, ndërsa dëshmi nuk ka ofruar se i posedon te njëjtat.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues për shkelje te nenit 10, i cili pretendon se AK-ja, i ka dhënë qasje te kufizuar, eksperti shqyrtues, sqaron se qasja e kërkuar nga OE ankues është aprovuar nga AK-ja, dhe poashtu AK-ja, sipas dispozitave te nenit 10 te LPP-se, është e obliguar qe te siguroj qasje te plot ne dokumentacion me përjashtim te dokumenteve te cilat janë te përfshira ne kërkesën e operatorit ekonomik, e qe ne rastin konkret nuk ka kërkesë për sekret afarist nga dy OE-te për te cilët ankuesi ka pretendime.

Sqarimi nr.4

Eksperti shqyrtues, ne fund te analizimit dhe shqyrtimit te pretendimeve ankimore sqaron se ne këtë aktivitet te prokurimit, AK-ja, gjate fazës se Ri-vlerësimit nuk e ka respektuar vendimin e PSH-se me nr. 444/16 te datës: 16.01.2017. Siç u cek edhe me lart OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar te gjitha kriteret teknike / profesionale ne lidhje me vinçin, kontrata dhe referencat dhe inxh. e Gjeodezisë, te kërkuara ne dosje te tenderit. Ndërsa OE "H-Project&Pleqja", nuk i ka plotësuar kriteret e gjendjes ekonomike dhe financiare poashtu edhe disa nga kriteret teknike / profesionale, siç u ceken edhe me lart dhe ne mungesë te këtyre dëshmive janë te papërgjegjshëm.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Komuna Gjilan (KGJ)**, për aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i palestrës sportive në fshatin Zhegër" me numër të prokurimit GI651/16/045/511,** nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.
- Prandaj, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta anulojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe propozon që ky aktivitet i prokurimit të **Rivlerësohet,** ndërsa ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar.
- Gjithashtu eksperti shqyrtues rekomandon AK-së, që gjatë rivlerësimit të ofertave të zbatohen në tërësi dispozitat e LPP-së dhe të merren parasysh kërkesat e parapara në dosjen e tenderit.